


Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 09 Nr. 391/02-0091068/18 dt. 28.06.2018, të investitorit “Uniproject” Sh.P.K me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës administrative, me etazhitet B+S+P+9+NK, në rrugën “Bajram Kelendi”, Lagjja “Dodona” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative me datwn 14.11.2018, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarëve Fetah Neziri, Agim Raifi, Sherafedin, Erhan dhe Beqir Ismajli të gjithë nga Prishtina, me investitorin “**Uniproject**” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, sipas kërkesës 09 Nr. 391/02-0091068/18 dt. 24.09.2018, për përdorimin e ndërtesës me destinim banim dhe afarizëm, me etazhitet B+S+P+9+NK, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-70114059-101144-0, Zona Kadastrale Prishtinë sipas Vendimit 05 nr.351-121149 dt. 27.09.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-121149 dt. 27.09.2013, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrat kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Investitori “**Uniproject**” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, më kërkesën me 09 Nr. 391/02-0091068/18 dt. 24.09.2018, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës administrative, me etazhitet B+P+9, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Raportin Final të Inspektimit, me akt përcjellës, i përcjellë nga Drejtoria e Inspekcionit.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë,
- Protokollat e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografji gjatë procesit të ndërtimit,
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,

- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas plotësimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes shkresës 05 Nr. 391/02-0091068/1/18 dt. 22.10.2018, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, mbrojtje nga zjarri dhe punëve zejtare, konstatohet se gjatë realizimit të ndërtesës janë realizuar disa ndryshime vetëm në brendësi të ndërtesës, ndërsa në gabarit nuk ka pasur asnjë ndryshim. Ndryshimet në brendësi të ndërtesës, janë të aspektit funksional, ndërsa është ruajtur koncepti i përgjithshëm arkitektonik, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa administrative mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit 05 Nr.351-79392 të datës 19.07.2016 janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë ndërmarrë.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+9+Nk, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
09 NR. 391/02-0091068/18 DT. 14.11.2018**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Lindita Beqiri



Drejtori:

Ardian Olluri

